



## NJOFTIM PËR SINJALIZIM

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS



Të nderuar/a,

Si Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ju informoj se, pavarësisht kufizimit të lirisë së lëvizjes suaj si pasojë e aktgjyqimit dënues që po ekzekutohet ndaj jush, legjislacioni në fuqi për ekzekutimin e sanksioneve penale ju njeh dhe garanton një varg të drejtash dhe beneficimesh gjatë qëndrimit tuaj në institucionet korrektuese.

Me qëllim të sigurimit të drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave tuaja gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale, ju inkurajoj që për çdo shkelje ligjore që ndërlihet me realizimin e të drejtave dhe beneficioneve tuaja, të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, ta raportoni. Gjithashtu, ju sugjeroj që çdo abuzim apo keqtrajtim që mund të përjetoni gjatë qëndrimit tuaj në institucionet korrektuese, qoftë nga personeli apo të burgosurit, ta raportoni.

Ju siguroj se sinjalizimi mund të bëhet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale. Për mbrojtjen e të drejtave tuaja, mund të kontaktoni personin përgjegjës për sinjalizim, i cili vepron në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në adresën e poshtëshënuar ose përmes kanaleve të tjera të përcaktuara për sinjalizim.

Identiteti juaj do të mbrohet, dhe nuk do të përballeni me pasoja për shkak të raportimit të drejtë dhe të ligjshëm. Çdo raportim nga ana juaj do të trajtohet me seriozitet dhe në përputhje me ligjin nga zyrtari përgjegjës.

Duke ju uruar një proces të suksesshëm riedukimi dhe socializimi, ju falënderoj për vëmendjen!

Nëse keni nevojë për informacion shtesë mbi procesin e sinjalizimit, ju lutem drejtohuni te zyrtari përgjegjës në numrin dhe adresën e kontaktit si më poshtë:

Valon Gashi,  
Zyrtar Përgjegjës për Sinjalizim  
Numra të kontaktit:  
Mobil: 044-553-794  
Tel Lokal: 038-200-67632  
Adresa elektronike: [valon.i.gashi@rks-gov.net](mailto:valon.i.gashi@rks-gov.net)

Me respekt,  
Ismail Dibrani,  
Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës

2024